



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË

P/ VENDIM

Nr. _____, datë _____.2025

MBI

“MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE, TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (SOT ASHK) PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT” PËR Z. LAVDAR SEITI ETJ..

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 2, 23 , Ligjin Nr 22/2018, “Për Strehimin Social” i ndryshuar, për banesat dhe objektet e kthyer në të ndërtuara nga shteti , të cilat vijojnë të jenë në pronësi të shtetit e rezultojnë të paprivatizuara në regjistrin kadastral të pasurive të paluajtshme , VKM, Nr 179, datë 26.02.2020 “Për rregullat dhe procedurat e privatizimit të banesave qe kanë qenë subjekt i ligjit Nr 7652, datë 23.12..1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe të ligjit Nr 9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”.Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë, në mbledhjen e datës ____/____/2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

- Të përfundohen procedurat e privatizimit të apartamenteve, përkatësisht lidhja e kontratave të shitblerjes para noterit, banesat e të cilëve kane mbetur pa u regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë, për

Nr.	ADRESA	EMRI MBIEMRI
1.	Pallati 89, Lagjia “18 Shtatori”	Lavdar Seiti etj...

- Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Gjirokastrës ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës së privatizimit.
- Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT
Merita ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

P\ VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ .2025

**“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” PËR Z. ROLAND HARRILLA
TASHO”**

Në kuadër të vlerësimit të figurës së z. Roland Harrilla Tasho, si dhe në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika (m) si dhe Ligjit", Ligji nr 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit, V.K.M Nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimorë për dhënie të medaljeve dhe titujve vendorë të nderit", bazuar në relacionin e Komisionit Vendor për Titujt e Nderit dhe kërkesën e kryetarit të bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës, ____ . ____ .2025

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënie të titullit “Qytetar Nderi” z. Roland Harrilla Tasho me motivacionin :

“Për shërbime të shquara për qytetin e Gjirokastrës në promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, traditës, historisë, turizmit, personaliteteve të shquara brenda dhe jashtë vendit”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Trashëgimisë, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” .

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

P/ VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ .2025

“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” PËR Z. ROLAND DEMO ÇENKO”

Në kuadër të vlerësimit të figurës së z. Roland Demo Çenko, si dhe në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika (m) si dhe Ligjit", Ligji nr 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit, V.K.M Nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimorë për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit”, bazuar në relacionin e Komisionit Vendor për Titujt e Nderit dhe kërkesën e kryetarit të bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës, ____ . ____ .2025

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e titullit “Qytetar Nderi” z. Roland Demo Çenko me motivacionin

“Mirënjohje dhe respekt për mjeshterin e polifonisë dhe monofonisë.

Për kontributin që jep në lëvrimin, mbrojtjen dhe transmetimin të brezave të rinj të isopolifonisë e cila është Pasuri e Paluajtshme e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale e mbrojtur nga UNESCO. Për magjinë që u shton kalldrëmeve të qytetit tonë me talentin e tij të veçantë”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Trashëgimisë, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË

P/ VENDIM

Nr. _____, datë _____. _____. 2025

MBI

“MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE, TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (SOT ASHK) PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT” PËR Z. PANAJOT KAMBERI ETJ..

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 2, 23 , Ligjin Nr 22/2018, “Për Strehimin Social” i ndryshuar, për banesat dhe objektet e kthyer në të ndërtuara nga shteti , të cilat vijojnë të jenë në pronësi të shtetit e rezultojnë të paprivatizuara në regjistrin kadastral të pasurive të paluajtshme , VKM, Nr 179, datë 26.02.2020 “Për rregullat dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit Nr 7652, datë 23.12..1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe të ligjit Nr 9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”.Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë, në mbledhjen e datës ____/____/2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

- Të përfundohen procedurat e privatizimit të apartamenteve, përkatësisht lidhja e kontratave të shitblerjes para noterit, banesat e të cilëve kanë mbetur pa u regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë, për

Nr.	ADRESA	EMRI MBIEMRI
1.	Lagjia “18 Shtatori”	Panajot Kamberi, ETJ...

- Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Gjirokastrës ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës së privatizimit.
- Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT
Merita ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI I BASHKISË

P/VENDIM

NR __, DATË __. __. 2025

"PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT "HARTIMI I PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMIVE

PYJORE: PICAR, KARDHIQ, MALI I GJERË, LUNXHËRI

KULLOSORE: PICAR, MALI I GJERË, ZHULAT, LUNXHËRI "

Në mbështetje të nenit 8, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1/a dhe b, nënpika 1.2 shkronjat "a dhe c", neni 27 pika 5 dhe 6, neni 54 shkronja e dhe k, në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, në Ligjin nr 57/2020 datë 30.04.2020 "Për pyjet", neni 3 pika 26, neni 11, në Ligjin nr. 9693 datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar, neni 3 pika 12. neni 14, në Ligjin nr. 5/2016 datë 04.02 2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.361, datë 12.05.2010 "Per miratimin e tarifave të shërbimeve profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullosor publik". Rregullores nr 3, datë 08.07.2009 "Për certifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota" me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe bazuar në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë,

Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë në mbledhjen e datës __. __. 2025

VENDOSI:

1. Të miratojë Hartimin e Planit të Mbarështimit të ekonomisë;
Pyjore: Picar, Kardhiq, Mali i Gjerë, Lunxhëri
Kullosore: Picar, Mali i Gjerë, Zhulat, Lunxhëri sipas dokumentacioni bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sektori i Pyjeve dhe Kullotave ne A.B.P.U.K të Bashkisë Gjirokastrë për përgatitjen e dokumentacionit përkatës dhe ndjekjen e procedurave të mëtejshme për miratimin e planit sipas pikës 1.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Bujqësisë, Ujitjes dhe Kullimit dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"si dhe pas miratimit nga Prefekti i Qarkut.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita Isaraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI

P/VENDIM

Nr. __ date __. __. 2025.

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
BASHKISË PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE
PËR MUJIN TETOR 01-31.10.2025.**

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, vendimit Nr 85 datë 10.02.2021, si dhe bazuar në Udhëzimi nr.4 datë 17.02.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pika 7, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit 68/2017 “Mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore” VKB nr. 86 datë, 12.12.2024 për “Për Miratimin Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025” është miratuar fond “Ndihma Ekonomike” me fond limit 2.000.000 lekë/vit, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë;

VENDOSI:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Tetor 2025, 48 individë/ familje me fond 142,718 lekë.**
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT
Merita ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

P/V E N D I M

Nr. _____, datë _____ .2025

**"PËR NJË NDRYSHIM TË VKB- SË NR. 85,DATË 12.12.2024 "PËR MIRATIMIN E
NUMRIT MAKSIMAL TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË
GJIROKASTËR PËR VITIN 2025"**

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligji 44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM- së nr. 893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për proçedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", Ligjit Nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, Ligjit nr. 89/2022 " Për Policinë Bashkiake", Vendimit nr. 113, datë 1.3.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", VKM nr. 425, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në Institucionet arsimore dhe në Institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”, VKM nr. 419, datë 26.06.2024 "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", Vendimit nr. 503, datë 01.08.2024 Për disa ndryshime në Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM -së nr. 421, datë 26.06.2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të Zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunës civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike," të ndryshuar", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 86 , datë 12.12.2024 “Për miratimin e PBA 2025- 2027 dhe buxhetit vjetor 2025", VKB Nr. 85, datë 12.12.2024 "Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2025", Urdhrit nr.730, datë 27.09.2024 të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër, "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2024", i ndryshuar, Urdhrit nr. 835, datë 30.10.2024 " Për miratimin e strukturës analitike të

Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2024", i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës _____.2025;

V E N D O S I :

1. Të miratohet ndryshimi i pozicionit nga Mirëmbajtës rrjeti në pozicionin Specialist në strukturën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Arkivës dhe Protokollit.
2. Të miratohet ndryshimi i nivelit të pagës nga (paga bazë) 41 800 (dyzet e një mijë e tetëqind) lekë në 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë sipas kategorisë IV -2, Vkm nr. 503 datë 01.08.2024 lidhja nr. 5.
3. Të bëhet ndryshimi i numrit të pozicioneve të shërbimit civil nga 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) nëpunës civil në 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) nëpunës civil.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË GJIROKASTËR

P/V E N D I M

Nr. ____ Datë. ____ . ____ . 2025

**“ PËR MIRATIMIN E KOMISIONIT TË STREHIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE
TË STREHIMIT ”**

Në mbështetje të nenit 24 pika 2, , nenit 54 shkronja “k”, të ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, ligjit Nr.22/2018 , “Për strehimin social”, i ndryshuar, neni 2 pika 51 , Vendimit Nr. 384 datë 12.06.2019 “ Përpërcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas cdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore.”

V E N D O S I:

1. Ngritjen e komisionit të strehimit me përbërje si mëposhtë:
 1. Nertil Nebiaj – Kryetar Komisioni, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Gjirokastrë,
 2. Melpomeni Manxhari- Anëtar, Drejtor, Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, Bashkia Gjirokastrë
 3. Jonalda Gjini- Anëtar, Specialiste, Drejtorisë Juridike, Bashkia Gjirokastrë,
 4. Vasillaq Ajdini – Anëtar, Kryetar i Komunitetit Rom, Bashkia Gjirokastrë,
 5. Teuta Murataj- Anëtare, Kryetare e Shoqatës së Invalidëve të Punës, Bashkia Gjirokastrë,
2. Funksionimin e Komisionit të Strehimit sipas kuadrit ligjor që rregullon fushën e strehimit social.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit të tij.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva YZO

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI

P/ VENDIM

Nr. ____ datë ____ . ____ .2025

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMI E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK- NDIHMËN EKONOMIKE DERI NE 6% PËR MUAJIN TETOR 01-31.10.2025.

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597, date 04.09.2019 për “Për Përcaktimin e Procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë, me propozim të kryetarit të bashkisë Gjirokastrë;

VENDOSI:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **Tetor 2025, 6 (gjashtë), individë/ familje** me fond **22,531 lekë**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KËSHILLIT
MERITA ISARAJ**